



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ
Nr. 01-069/01-0003843/25
Data 23.01.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 24.12.2024, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Draft-Plani i punës së kuvendit të komunës së Skenderajt për vitin 2025, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit **znj. Adelina Spahiu**);
5. Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt për vitin 2025, me Nr.02-463/01-0055311/24, të datës 11.12.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
Pika sheshtë:
6. Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025, Nr.02-112/01-0056311/24, datë 20.12.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
7. Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024, me Nr. 02325/04-0056708, datë 23.12.2024, (Raporton drejtori i DSHP, **Alban Shala**);
8. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu: I nderuar kryetar i komunës Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 28 anëtar, mungon me arsye Ragip Durmishi, Besnik Ahmeti dhe Hysni Mehani.

Para miratimit të rendit të ditës i kemi dy pika sheshtë:

-Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025, Nr.02-112/01-0056311/24, datë 20.12.2024, Shkojmë në votim për futjen në rend dite: Konstatojmë me (18) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim, futet në rend dite Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025. Vazhdojmë me pikën tjetër;

-Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024, me Nr. 02325/04-0056708, datë 23.12.2024, Shkojmë në votim për futjen në rend dite: Konstatojmë me (18) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim, futet në rend dite Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024.

Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj;

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, të nderuar anëtar të kuvendit komunal, ne Lista IDEAL, largohem nga kjo seancë për të shprehur revoltën tonë ndaj qeverisjes komunale në Skenderaj, e cila vazhdon të mbaj në detyrë drejtorin e prokurimit Haxhi Bejta, pavarësisht së është

i dënuar me 2 vite e 6 muaj për bashkëpunim në Leposaviq. Ju bëjë thirrje të gjithë asambli stëve pa dallim pozitë opozitë mos u bëni dekor i kësaj qeverisje skandaloze lëshone seancën dhe dërgoni një mesazh të qartë qytetarëve të Skenderajt se ne si përfaqësues të tyre jemi kundër këtij skandali dhe dënojmë fuqishëm mos veprimin nga kryetari Fadil Nura, dhe ju njoftojmë së Lista IDEAL, do ti bojkotojmë gjitha seancat e kuvendit derisa të shkarkohet drejtori i prokurimit.

Floriana Halili-LVV: Fjala përshëndetëse, edhe ne si Lëvizje vetëvendosje, kërkojmë shkarkimin e drejtorit Haxhi Bejta, dhe e lëshojmë mbledhjen.

Kryesuesja; Dikush tjetër, nëse nuk ka, Lista IDEAL dhe LVV, e lëshojnë seancën, për mos shkarkimin e drejtorin e prokurimit Haxhi Bejta, fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetës, e drejta demokratike është pjesë e demokracisë që së cili subjekt politik ka të drejtë të lëshoj seancën, po e ndjejë obligim me ju njoftua sa i perkës kërkesës së opozitës, Haxhi Bejta si drejtor i prokurimit e ka ofruar dorëheqjen që 10 ditë, po pas festave të vitit të ri sigurisht do të aprovoj atë kërkesë, sepse kërkesën dhe vendimin e kam në tavolinë, po për faktin së nuk kemi drejtor të certifikuar të prokurimit edhe sot kemi pas pagesa që është dashur me i përfundua dhe parimisht Haxhi Bejta nuk është drejtor, dhe nuk bij në presione të opozitës në raste konkrete, është vendimi i gjykatës dhe do e respektoj vendimin e gjykatës dhe gjithçka është e qartë në këtë drejtim.

Kryesuesja, Dikush tjetër, nëse nuk ka konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim; Konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Draft-Plani i punës së kuvendit të komunës së Skenderajt për vitin 2025, (Raporton);

Kryesuesja e Kuvendit Adelina Spahiu; Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2025, Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore. Këtë plan e kam hartua me bashkëpunim me sekretarin e kuvendit, janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne dhe urgjente, sipas LVL dhe Statutin e Komunës, e hap debatin nëse nuk ka, shkojmë në votim.

-Konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2025.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt për vitin 2025, Nr.02-463/01-0055311/24, dt.11.12.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Para vetes e keni një listë që është e njëjta e vitit të kaluar që na obligon ligji që ti listojmë listat e pronave që eventualisht mundën me qenë interes i komunës për dhënien në shfrytëzime duke i përfshirë pronat me qira, afatshkurtër, afatgjatë, listën e keni pas me kohe para vetes, ju ftojë me përkrah këtë listë.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt për vitin 2025.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

-Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025, Nr.02-112/01-0056311/24, datë 20.12.2024, (Raporton) **Kryetari i Komunës Fadil Nura**; Materialin e planit të punës së ekzekutivit nuk e keni marr me kohe, sepse plani vazhdimisht ka qenë në seancën e janarit, po me qenë së e kemi si kritere për performancë është kërkuar ta prezantojmë në këtë seancë. Është një plan i hartuar nga ekzekutivi i cili përfshin aktivitetet angazhimet në arritjen e objektivave si ekzekutiv, ndoshta nuk është i përkryer, kërkojmë edhe nga ju të jepni kontributin aty ku e vlerësoni me ndonjë vërejtje kritik neper çdo drejtori.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Sala Jashari-PDK: Fjala përshëndetëse, Komuna e Skenderajt ka bërë një pune të shkëlqyer gjatë vitit 2024 duke i adresuar shume nevojat e qytetarëve, duke investua në projektet e rëndësishëm, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve, disa kërkesa janë të cekura si kërkesa në këtë planë, po disa prej tyre po i ngritit për me i pas parasysh në vitin 2025 si: I. Shtrimi i rrugës në lagjen Nezaj Prekaz i Epërm, me një gjatësi prej rreth 200m, që kjo rrugë është jetike për këta banor, si ja lehtëson punën e tokave bujqësore, lidh lagjen me varrezat, shkurton rrugën për nxënësit për në shkollë, dhe ndërtimin e një trotuari për sigurinë e fëmijëve dhe këmbësorëve? II. Kërkesë e banorëve të Runikut është ndërtimi i një trotuari në rrugën Tafë Hysenaj, për ta garantuar sigurinë e nxënësve që përdorin këtë rrugë për të shkuar në shkollë? III. Kërkesë e banorëve është Kanalizimi dhe Infrastruktura në Kopiliq të Epërm në rrugën Daut Dervishi, 15 shtëpi nuk janë të kyçur në rrjet të kanalizimit, dhe disa rrugë në këtë fshatë kërkojnë renovime dhe disa rrugë kërkojnë ndërtim prej fillimi? Edhe në seancat e kaluara kam përmendur disa herë ndriçimin publik për rrugën që e ligje Prekazin e Ultë me pjesën e rrugës që të qon të lagjja Lushtak është e vetmja rrugë që nuk ka ndriçim? Këto janë kërkesat të qytetarëve që besoj do të reflektojnë në vitin 2025.

Miradije Buliqi-PDK: Fjala përshëndetëse, drejtor që nga fillimi i mandatit e deri me sot, shumicën e seancave dhe dëgjimeve publike që i kemi mbajtur në mesin e kërkesave që i kam bërë janë; Përfundimi i projektit të kanalizimit, Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit, dhe Ndriçimi publik në fshatin Qubrel, a ka lëvizë diçka në këtë drejtim, a mundesh me na dhëne detaje dhe a ka gjasa me përfundua vitin e ardhshëm këto projekte?

Ali Lutfiu-PDK: Fjala përshëndetëse, desha me u ndërlidh të lagjja Nezaj që e përmendi Sala, si kërkesë e kam bërë edhe unë për këtë rrugë, dhe e përkrahi kërkesën që e bëri Sala, dhe kërkoj shtimin e kësaj rruge dhe trotuarin për ata banor.

Besiana Thaçi-PDK: Fjala përshëndetëse, Në planin e punës të ekzekutivit, të pjesa e punimeve të ujësjellësit në Burojë figuron që ka përfunduar ky projekt, po me atë që unë di ky projekt në fsh. Burojë nuk ka përfundua, a mundesh me na sqarua? Të pjesa e trotuareve dhe ndriçimi publik neper BL, e kam bërë me herët një kërkesë për fshatin Kopiliq të Poshtëm për trotuar në rrugën Sejdi Reka, fatkeqësisht në këtë rrugë e kemi pas një aksident që ka përfundua me fatalitet dhe besoj që një ndërtim i një trotuari është shumë i nevojshëm? Gjithashtu të rruga Mula Ilaz Buroja edhe kjo rrugë ka nevojë për trotuar dhe kemi pas aksidente po fatmirësisht pa fatalitet? Të pjesa e rrugëve neper fshatra kam bërë kërkesë për fshatin Burojë që shpresoj që në vitin 2025 kanë me përfundua së nuk kanë mbete edhe shume.

Liridona Koci-PDK: Fjala përshëndetëse, Rrethoja e shkollës në Polac, nuk është ndërmarr diçka, e kam ngrit si çështje edhe me herët, është shumë e nevojshme kjo rrethoj për këtë shkollë sepse është shumë afër rrugës kryesore që paraqet rrezik për të madh për nxënësit? Një çështje tjetër që e kam ngritur edhe me parë, po edhe kam bërë edhe kërkesë me shkrim është numri i shtëpive, që nuk është ndërmarr as një veprim në këtë aspekt? Rregullimi i kanalizimit në disa lagje të Polacit

si dhe asfaltimi i rrugicave që këtë pyetje e kam parashtruar disa herë? Për DSHP, kur do të përfundon ndriçimi publik në Polac, në disa lagje veç ka përfundua?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Sala sa i përket trotuarit e kemi në kod buxhetor në këtë vite jemi në përfundim në Prekaz të epërm, dhe do të vazhdojmë aty ku ka prioritet, Ndriçimi publik është i përfshirë nëpër gjithë BL. Sa i përket, në fletën e fundit të drejtorisë sime është Asfaltimi i rrugëve neper fshatra janë 16.4 km, është kontrata me ministrin, dhe vitin e ardhshëm kemi me i përfundua. Kanalizimi në Kopiliq të epërm e kemi kontratën neper BL, dhe jemi tu i dhanë prioritet disa fshatra dhe vitin tjetër kemi me i përfundua të gjitha lagjet. Miradija, kanalizimi ne Qubrel e kemi premtua, po s'kemi buxhet, kontratën e kemi, vitin e ardhshëm kryhet. Ujësjetësi në Burojë e kemi cek që është përfundua dhe është i përfundua si projekt, tash e kemi kontratën kyqjet individuale dhe pothuajse jemi në përfundim. Liridona s'po kemi buxhet se tan rrugët i kishim përfundua.

Ali Lutfiu-PDK: Për drejtorin e urbanizmit, për planin e punës e kam një pyetje-kërkesë desha me ditë saktë, për tri familje në fshatin Polac ndërmjet lagjes Hoti dhe Koci ato familje krejt çka kanë ndërtua e kanë ndërtua me buxhet të vetin si kanalizimin si rrugën, saktësisht për familjen e Milaim Koces, dhe janë të interesuar vetëm për asfaltim të rrugës a është në plan të shtrohet kjo rrugë?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Fjala përshëndetëse, Liridona e kemi një kontratë për renovim të shkollave, po jemi tu e pritë një përgjigje për çerdhe , dhe deri të marrim përgjigjen nuk po mundem me ndërhy për rregullimin e kësaj rrethoje, dhe nëse nuk marrim përgjigje do të intervenojmë në rrethoje.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Liridona për nr. e shtëpive, nuk kemi kontratë, për me i vendos numrat, kjo shkon përmes drejtorisë, vetëm qytetaret letë vinë të marrin një pëlqim dhe nuk kushton shumë numri le të blejnë vet. Të rruga e profes kemi me përfundua vitin e kaluar.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:

-Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024, me Nr. 02325/04-0056708, datë 23.12.2024, (Raporton);

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024, Dëme janë shkaktuar në bujqësi dhe, në ekonomi familjare, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej 102,464.12€, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës, Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, pyetjet kalojnë në seancën tjetër, me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi

